REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 231, datë 19.12.2019

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË "AGORA SECURITIES" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt" dhe nenit 18/1, të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime", Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 17.2 të statutit të shoqërisë "Agora Securities" sh.a., lidhur me anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe nenit 19.3 lidhur me Administratorin e shoqërisë, sipas projektstatutit të depozituar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR **DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

Ervin METE **Ervin KOÇI**